



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e martë, më 2 maj 2023, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive, (AMA) u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Miratimin e raportit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 23 – 30 prill 2023 (**Vendimi nr. 33, datë 02.05.2023**).
2. Rinovimin e licencës së shoqërisë “TOK MEDIA” sh.p.k, për subjektin audio privat “In Radio 105.7”, për një periudhë 7 (shtatë) vjecare (**Vendimi nr. 34, datë 02.05.2023**).
3. Rinovimin e licencës së subjektit “Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë”, për subjektin audio të komunitetit “Radio Ngjallja” dhe ndryshimin e kushteve teknike të licencës (**Vendimi nr. 35, datë 02.05.2023**).
4. Vendosjen e sanksionit me gjobë ndaj subjektit audioviziv “TV KLAN” për shkelje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, gjatë transmetimit të emisionit “Opinion” në datën 20 prill 2023 (**Vendimi nr. 36, datë 02.05.2023**).

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 2 maj 2023